

VENDIM
Nr. 368, datë 30.4.2013

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE
CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË
KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT,
KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME,
DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT,
INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E
PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 4/2 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në nënndarjen e tretë të pikës 6 të vendimit nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas emërtesës “Drejtor i kabinetit të Avokatit të Popullit” shtohet emërtesa “Koordinator Kombëtar për urdhrat profesionalë, pranë Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga momenti i emërimit të nëpunësit në detyrë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha